



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 4005/1 Prot  
08.06.2026  
REPUBLICA E SHQIPËRISË  
SEKRETARIA  
BASHKIA VAU DEJËS

436/1  
Nr. prot.

Shkodër, më 08.06.2026

**Lënda:** Mbi Vendimin Nr. 36, datë 28.05.2026 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" i përditësuar, u njoh me Vendimin Nr. 36, datë 28.05.2026 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës për subvencion qeraje për zotin P.Z, akt me karakter njohës, me karakter jo normativ, për të cilat Prefekti referuar ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", nuk ka detyrim të shprehet. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI  
Jeta DUDA  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK****VENDIM**Nr. 36 Datë. 28 . 05 .2026**“Për miratimin e së subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për z.Pjeter Zefi në programin e strehimit “Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë”**

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit38 i Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”i ndryshuar;VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;VKM-së nr.362 prot,datë 29.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 “Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026” në Bashkinë Vau Dejës; VKB-së nr.40, datë 28.06.2021 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencion i qirasë në tregun e lirë”; VKB Nr. 57 me 27.10.2025 “Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit ” VKB-së nr. 47, datë 26.06.2024 “Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë , për familjet qe perfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”. Proceverbali i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datë 23.04.2026,Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI**

1.Miratimin e së subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për z. Pjeter Zefi në programin“Subvencion i qirasë në tregun e lirë” sipas tabelës dhe pjesës përbërëse të këtij vendimi.



2. Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesit që nga momenti i miratimit të listës së përfituesve me vendim të këshillit të vetëqeverisjes vendore, (pika 4 neni 39, ligji 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar).

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet "Drejtoria e Mbrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social, Sektori i Strehimit Social"

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ndryshuar).



**KRYETAR KËSHILLI**

Ervis Shumaj

**SEKRETAR KËSHILLI**

Ardian Çelepija

Miratuar me 16 vota

Vota Pro 16

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.06 2026



Programi: Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë.

Vlera maksimale e subvencionit të qiras në tregun e lire, për familjet që përfitojn subvencionin e qiras në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave dhe të ardhurave të familjes

Nr Rendor	Emër	Mbismër	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018	Përberja Familjare	Struktura e Baneses (Shtëpi Private)	Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave VKB nr. 47; datë: 26.06.2024	Qiraja reale	Të ardhurat Familjare mujore (neto)	Aftësia përballues e(%)	Qiraja e shme përballua	Subvencio që mirahet nga bashkia në Lek	Subvencio Shuma që kërkohet nga bashkëti i shtetit në Lek	Subvencionit në vit në Lek	
1	Pjeter	Zefi	Familje pa të ardhura sipas nenit 2, pika 45 e ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social"	1	2+1	21,000	15,000	11,291	0.15	1,694	13306	0	159,676.0	
Total/muaj												13306	0	159,676.0

Shënim: Subvencionimi i qirasë fillon që nga momenti i miratimit të vlerës me vendim të këshillit të mesisë së vetëqeverisjes vendore- dëri në ndryshimin e kushteve social ekonomike të banorit.



KRYETAR  
Ervis Shima

Sekretari i Këshillit Bashkësiq  
Ardian CELEVA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL  
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

PROJEKTVENDIM

Nr. 6 datë 04.05.2026

**“Për vazhdimësinë dhe vlerën e perfitimit për z. Pjeter Zefi në programin e strehimit  
“Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë”**

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit38 i Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”i ndryshuar; VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;VKM-së nr.362 prot,datë 29.05.2019. “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 “Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026” në Bashkinë Vau Dejës; VKB-së nr 40, datë 28.06.2021 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencion i qirasë në tregun e lirë”; VKB Nr. 57 me 27.10.2025 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr.21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit“Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”. Proces-Verbali i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datë 23.04.2026 .

## VENDOSI

1. Miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit për z. Pjeter Zefi në programin "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë", sipas tabelës dhe pjesës përbërëse të këtij vendimi.
  2. Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesit që nga momenti i miratimit të vlerës me vendim të këshillit të vetëqeverisjes vendore, ( pika 4 neni 39, ligji 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar.
  3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet "Drejtoria e Mbrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social, Sektori i Strehimit Social"
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**KRYETAR**  
Kristian Shkreli

Në mungesë dhe me urdhër

ZV/KRYETARI

Aleksandra



Konceptoi: E.Gjeca

Pranoi: D.Lleshi

Miratoi: R.Luzaku

Konfirmoi Bazen Ligjore: E.Preka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL  
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Nr.     prot.

Vau Dejës, më 04.05, 2026

RELACION

**“Për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit për z. Pjeter Zefi në programin e strehimit “Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë”**

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar, Bashkia Vau Dejës po zbaton disa nga programet e strehimit social, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë/familje që me të ardhura e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë.

Subvencioni i qirasë realizohet nga bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.

Për këtë instrument në zbatim të programit të strehimit “Subvencion i qirasë, në tregun e lire” është ndjekur procedura , sipas VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr. 57 me 27.10.2025 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr.21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit

Me datë 23.04.2026 u bë shqyrtimi i dokumentacionit të plotë i rinovuar dhe kontratës së qirasë noteriale për banorin Z. Pjeter Zefi nga komisioni i strehimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, kontratës së qirasë dhe gjendjes sociale e ekonomike të banorit, komisioni vendosi kualifikimin e dosjes së Z. Pjetër Zefi, si aplikues me dokumentacion të rregullt.

Për llogaritjen e vlerës së subvencionit të qirasë Komisioni i Strehimit u bazua në VKM-në nr.362 prot, datë 20.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, dhe realizohet nëvarësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës maksimale të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB nr. 47, datë 26.06.2024 “Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në

tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave". Vlerat konkrete të subvencionit të qirasë për çdo përfitues përcaktohen sipas kontratave të qirasë të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas Shtojcës "A" të VKM-së nr.362, datë 20.05.2019.

Lista e dhe vlera e subvencionit të qirasë janë të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur projekt-vendimit nga ku është detajuar edhe efekti financiar që rrjedh për zbatimin e këtij programi që do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vau Dejes.

Në këto kushte për realizimin e këtij programi të strehimit social duhet të miratohet në këshill bashkiak projekt vendimi i propozuar "Për miratimin e vlerës së subvencionit të qirasë për aplikuesit kërkuar në programin e "Subvencionit të qirasë, në tregun e lirë"

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!**

Konceptoi: E.Gjeca 



BASHKIA VAU DEJËS  
Komisioni i Strehimit

Nr. 3182 Prof.

Vau Dejës më 23.09 . 2026

Proces -Verbal  
"Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë"

Sot me datë 23.04.2026 ora 10.00, pranë njësisë administrative Bushat u mbajt mbledhja e Komisionit të strehimit në lidhje me sistemin e pikëzimit në zbatim të programeve të strehimit.

Paraprakisht është bërë aktkonstatimi në banesë nga grupi i punës me Nr. 54, datë 06.02.2026 "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e adresës së paraqitur në kontratën e qirasë noteriale".

Mbështetur në Ligjin 22/2018 "Për strehim social" (i ndryshuar), VKM Nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur sipas çdo programi social të strehimit dhe afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore"; "VKB Nr. 57 dt. 27.10.2025", "Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 21 dt. 26.03.2025", "VKB Nr. 33 datë 28.04.2023 VKB 30.10.2023 "Për ngritjen e komisionit të strehimit".

Komisioni shqyrtoi dosjen për rinovim, për përfitim në programin e strehimit "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë", për banorin: Pjeter Zefi.

Komisioni pas shqyrtimit të dosjes vendosi:

- Kualifikimin e dosjes së Z. Pjeter Zefi si aplikues me dokumentacion të rregullt për të përfutur nga programi "Subvencioni i qirase ne tregun e lirë"

Komisioni i Strehimit përbërë nga:

1. Dajana Lleshi - Kryetar
2. Silvana Ismailaj - Zv/Kryetar
3. Marian Marku - Anëtar
4. Indrit Kurtabegu- Anëtar
5. Marketa Lleshaj - Anëtar
6. Suella Domnori- Anëtar
7. Kujtime Nurja - Anëtar

Të pranishëm:

1. Dajana Lleshi -
2. Silvana Ismailaj -
3. Indrit Kurtabegu -
4. Marketa Lleshaj -
5. Marian Marku -



Programi Subvencional i Qirase në Tregim e Lirë

Nr. Rendor	Emër	Mbiamer	Kategoria sipas neni 16, të ligjit nr.22/2018	Përfitues Familjare	Struktura e Banesës (Shërbime private)	Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit që qirase në tregim e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirase në tregim e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave VVKB nr. 47; datë 26.06.2024	Qiraja reale	Të ardhurat Familjare majore (neto)	Aftësin e përballjes për ballaash e (%)	Qiraja e mirë	Subvencioni që mirëtohet nga bashkia në Lek	Shuma që kërkohet nga huahënës shtet në Lek	Subvencioni në vit në Lek
1	Pjeter	Zefi	Familje me të ardhura shtetë të ulëta sipas neni 16, të ligjit nr.22/2018 për Shërbimet Social	1	3.1	21.000	15.000	11.291	0.15	1.694	13306	0	159.676
Totali miraj											13306	0	159.676

Shënim: Subvencion i qirase filloz që nga momenti i miratimit të vlerës me vendim të keshillit të tregtisë së vetëqeverisjes vendore, deri në ndryshimin e kushteve social ekonomike të banorit.

**Komisioni i Shtetit**

1. Dajana Veseli Kuyetar

5. Marjeta Heshaj - Anëtar

2. Shpresa Ismailaj Zyrtëtar

6. Suela Domori - Anëtar

Marjan Marko - Anëtar

Kujtime Burja - Anëtar

Indrit Kurtabegji - Anëtar



A2026040040075514045

### KONTRATË QIRAJE

Sot, më datë 27/02/2026, para meje Noter FRAN GJ. GJONI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Lezhe, SKENDERBEG, LUIGJ GURAKUQI, NR. 43, NR. 1, NR. 1, u paraqit personalisht:

#### **QIRADHËNËS:**

**Zef Zefi**, atësia Ndue, amësia Dave, shtetas Shqiptar, lindur në Vig, Shkodër dhe banues në VAU-DEJËS, me adresë Perparimi 03380155; Nd. 5; H. 1; Vau-Dejës; Stajkë; 4021; Vau-Dejës, lindur më 08/12/1946, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034225604 dhe nr. personal E61208034T. *(këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet Qiradhënës).*

#### **QIRAMARRËS:**

**Pjeter Zefi**, atësia Ndue, amësia Mrike, shtetas Shqiptar, lindur në Shëngjergj, Mirditë dhe banues në VAU-DEJËS, me adresë Topallaj 03430045; Nd. 17; H. 1; Hajmel; Nënshatë; 4029; Vau-Dejës, lindur më 12/01/1949, gjendja civile "i ve", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036096477 dhe nr. personal E90112060D. *(këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet Qiramarrës).*

Palët kontraktuese me marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, deklarojnë se kanë rënë dakord që në bazë të besimit reciprok, kushteve aktuale të tregut dhe legjislacionit civil Shqiptar; e përkatësisht të neneve 801 e vijues të Kodit Civil; të lidhin këtë Kontratë Qiraje (këtej e tutje, "Kontrata") dhe kërkuan nga unë Noteri hartimin e saj, në përputhje me ligjin, si më poshtë vijon:

Qeradhënesi bazuar në "Certifikate Per Vertetim Pronesie" date 06/11/2006, është pronar i pasurisë me Nr.339/12, zona kadastrale 3506, faqe 3, volumi 58,lloji i pasurisë **Pemetore+Truall**, me sipërfaqe totale **437m<sup>2</sup>**, nga kjo **200m<sup>2</sup>** Truall, nga kjo **150m<sup>2</sup>** Ndertese, adresa e pasurisë **Shkoder**.

Bazuar në marrëveshjen e perbashket të dy paleve, është rënë dakort si më poshtë:  
Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera e nderteses se mesiperme.

Palet bien dakort që kohezgjatja e kontrates të jete **2 vite**, afat që fillon nga data **27/02/2026** deri me **27/02/2028**.

Palet kanë rënë dakort që pagesa mujore e qerese do të behet nga Qiramarrësi të Qiradhënesi në shumën prej **15 000 Lek**, ndërsa **15 %** i taksës së qirase ndaj shtetit do të paguhet nga qiradhënesi. Pagesa e qirase do të likujdohet brenda dates 05 të cdo muaji.

#### **Qiradhënesi ka të drejtat dhe detyrimet e meposhtme:**

Te garantoje Qiramarrësin për një përdorim të lirë të pasurisë gjatë periudhës së qerases. Te mbaje pasurinë e dhënë me qera në kushte të pershtatshme, të cilat duhet të jenë të pakten të njëjtat kushte ekzistuese si në datën e fillimit të kësaj kontrate. Te mos beje ndryshime, korrigjime ose fallsifikime të dokumentave që kanë lidhje me këtë qera.

#### **Qiramarrësi ka të drejtat dhe detyrimet e meposhtme:**

Qiramarrësi mer për siper të paguaje edhe detyrime që rrrjedhin nga konsumi vetjak i tij duke filluar që nga data e fillimit të kontrates (27/02/2026), si faturat e energjisë elektrike dhe të konsumit të ujit të pijshëm, telefonit, internetit dhe taksat relative.



A2026040040075514045

Nuk duhet te beje ndryshime te rendesishme te struktures se prones pa miratimin te Qiradhenesit. Çdo modifikim i kerkuar nga Qiramarrresi per prones do te behet me miratimin paraprak te Qiradhenesit. Te perdore Ambjentet per qellimet per te cilat ka rene dakort me Qiradhenesin. Qiramarrresi nuk ka te drejte t'u jape me qera kete prone personave te trete, pa miratimin me shkrim te Qiradhenesit.

Qiradhenesi i garanton Qiramarrresit se pasuria e marra me qera jane ne posedim te tij te plote dhe ligjore .

Ne rast te ndonje konflikti mbi pasurine ndermjet Qiradhenesit dhe personave te trete, Qiradhenesi eshte I detyruar ta zgjidhe ate vet personalisht, pa penguar Qiramarrresin te perdore lirisht ambjentet apo te permbushe qellimet e tij. Qiradhenesi ne rast se ka patur dijeni, eshte I detyruar te kompesoje dhe zhdemtoje Qiramarrresin per demet ose humbjet e shkaktuara nga pretendimet e personave te trete mbi ambjentet me qera, gjate periudhes kohore per te cilen kjo kontrate eshte e vlefshme. Demet apo humbjet duhet te vertetohen me dokumenta perkatese. Qiradhenesi duhet te lajmerojte me perpara Qiramarrresin per cdo marreveshje te tij ne lidhje me shitjen e pasurise.

**Qiradhenesi ka te drejte ta zgjidhe kete kontrate ne rast se:**

Qiramarrresi nuk paguan qerane si dhe detyrimet e tjera te parashikuara ne kete kontrate. Qiramarrresi ka bere ndryshime te rendesishme pa miratimin me shkrim te Qiradhenesit, pervec atyre punimeve qe konsiderohen si te nevojshme ne lidhje me qellimin e qerases se ambjenteve. Qiradhenesi nuk ka te drejte te zgjidhe kontraten ne menyre te njeaneshme nese nga qiramarrresit zbatohen kushtet e saj.

Qiramarrresi nuk ka te drejte te zgjidhe kontraten para mbarimit te ketij afati pervecse kur, pasuria nuk mund te perdoren per shkak difektesh te rendesishme, Nuk mund te perdore qetesisht ambjentet gjate afatit te kesaj kontrate, Nese qiramarrresi per arsye objektive eshte i detyruar te zgjidhe kontraten , eshte i detyruar te njoftojte qiradhenesin dy muaj para me shkrim.

Kjo Kontrate eshte hartuar ne baze te legjislacionit shqiptar dhe konkretisht te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise. Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj Kontrate, jane objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates kompetente Shqiptare.

Kjo kontrate eshte hartuar ne 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe.

Une, noteri publike pasi ua lexova kete kontrate me ze te larte paleve, u sigurova qe ata e gjejne ate konform vullnetit te tyre te lire, une vertetoj nenshkrimet e tyre ne perputhje me ligjin.

**QIRADHENESI**

**QIRAMARRRESI**

**NOTERI  
FRAN GJ.GJONI**